

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 30, datë 24.12.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 28.3.2025, “PËR
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT
PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR MASAT MBËSHTETËSE
PËR VITIN 2025”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6, të Ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 6.3.2025, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2025”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 14, datë 28.3.2025, “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimit rural, për masat mbështetëse për vitin 2025”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun VIII/II “Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe ekzekutimit të pagesave për masat 9–17”, bëhen ndryshimet si vijon:

a) Në pikën 4, në fjalinë e dytë, togfjalëshi “60 ditë kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve” zëvendësohet me togfjalëshin “datës 27.2.2026”;

b) Në pikën 5, togfjalëshi “afatit 60 ditë kalendarike nga afati i përfundimit të aplikimeve” zëvendësohet me togfjalëshin “datës 27.2.2026”.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE

Petrit Malaj

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla